



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 1077 Prot.

Patos, më 19/04/2024

MIRATOHET
KRYETARI
Faton Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 40, datë 19/04/2024

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE KUSHTEVE PËR LICENCIMIN E
AGJENCIVE TË SHËRBIMIT FUNERALE NË BASHKINË PATOS**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Mbështetur në shkronja “k” të nenin 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9220, datë 29.10.2014 “Për administrimin e e shërbimit të varrimit” i ndryshuar, vendimit nr. 402, datë 5.7.2023, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 711, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”, urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 70, datë 27.03.2024 “Për ngritjen e komisionit për hartimin e kriterëve dhe kushteve që agjencitë e shërbimeve funeral duhet të plotësojnë për licencim”, komisioni pasi hartoj kriteret kërkonë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

1. Miratimin e kriterëve dhe kushteve për licencimin e agjencive të shërbimit funeralë në bashkinë Patos, bashkëlidhur dhe pjesë përberëse e këtij projektvendimi.

KOMISIONI I HARTIMIT TË KRITEREVE

Ina Sauli

Ermenita Mici

Eneo Xhaferi

Nurkë Hazizaj

Gazmira Plesati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 1077/Prot.

Patos, më 19/04/2024

RELACION

“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE KUSHTEVE PËR LICENCIMIN E AGJENCIVE TË SHËRBIMIT FUNERALE NË BASHKINË PATOS”

Arsyeja e këtij projektvendimi është se me hyrjen në fuqi të vendimit nr. 402, datë 5.7.2023, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 711, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë” përcaktohet se e drejta për licencimin e agjencive të shërbimit funeral ju kalon njësisve të vetëqeverisjeve vendore. Ky vendim parashikon se bashkitë duhet të hartojnë kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë agjencitë në lidhje me kapacitetin teknik dhe burimet njerëzore dhe ti miratojnë ato.

Qëllimi dhe objektivat që synohen të arrihen nga kjo vendimarrje është zbatimi i legjislacionit në fuqi, menaxhimi më i mirë si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit si një nga funksionet e përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Përparësit dhe efektet e pritshme nga miratimi i kriterëve dhe kushteve për licencimin e agjencive të shërbimit funeral do të sjelli një shërbim më të mirë dhe efikas për komunitetin e bashkisë Patos.

Me urdhër të Kryetarit të bashkisë nr. 70, datë 27.03.2024 u ngrit një komision me specialist të fushave të ndryshme dhe të nevojshme për hartimin e kriterëve që agjencitë e shërbimeve funeral duhet të plotësojnë për licencim.

Agjencitë të cilat janë të licencuara dhe ushtrojnë aktivitet duhet ti plotësojnë kriteret që do miratohen brenda 6 muajve nga miratimi i tyre.


Komisioni pasi studioi nevojat e këtij shërbim specifik hartoi kriteret dhe kushtet për licencimin e agjencive të shërbimit funeral për sa i përket kapacitetit teknik dhe burimeve njerëzore për këtë shërbim dhe kërkonë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

Mbështetur në shkronjën “k” të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, vendimit nr. 402, datë 5.7.2023, për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 711, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”;

1. Miratimin e kriterëve dhe kushteve për licencimin e agjencive të shërbimit funeral në bashkinë Patos, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.
2. Për ndjekje dhe zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet ekzekutivi.

Ina Sauli

Nurkë Haziza



KOMISIONI I HARTIMIT TË KRITEREVE

Ermenita Mici



Eneo Xhaferi



Gazmira Plesati



KRYETARI
Fation Duro





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 1077 Prot.
2

Patos, më 19/04/2024

**KRITERET DHE KUSHTET PËR LICENCIMIN E AGJENCIVE TË
SHËRBIMIT FUNERALE NË BASHKINË PATOS**

- 1- Agjencia duhet të disponojë automjet për shërbimit funeral, i cili duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi me specifikën (shërbim funeral) në emër të subjektit, të jetë i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm ligjor si; siguracion, kontroll teknik i mjetit, taksat e mjetit.
 - 1.1. Automjeti duhet të jetë i veshur me fletë metali inoks ose me material tjetër të papërshkueshëm nga lëngjet që të pastrohen dhe dezinfektohen me lehtësi.
 - 1.2. Duhet të jenë të pajisura me karel për fiksimin e arkivolit që të mos lëviz gjatë transportit.
 - 1.3. Nuk lejohet të transportojë asnjë ngarkesë tjetër veç kufomës.
- 2- Agjencia duhet të disponojë automjet frigoriferik për shërbimit funeral, i cili duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi me specifikën (shërbim funeral) në emër të subjektit, të jetë i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm ligjor si; siguracion, kontroll teknik i mjetit, taksat e mjetit.
- 3- Agjencia duhet të disponojë mjet transporti (kamionçinë) në pronësi ose me kontrat qiraje të lidhur përpara noterit me kapacitet deri në 3.5 ton, mjeti të jetë i pajisur me; certifikat pronësie, leje qarkullimi, siguracion, kontroll teknik i mjetit, taksat e mjetit.
- 4- Për çdo lëvizje duhet të mbahet një regjistër i veçantë.
- 5- Automjetet duhet të dezinfektohen pas çdo përdorimi.
- 6- Vërtetim nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror për automjetet funerale.
- 7- Agjencia duhet të jetë e regjistruar në Qendrën Kombëtare të biznesit me objekt shërbim funeral.


- 8- Agjencia e shërbimit funeral duhet të ketë 4 punonjës të cilët duhet të figurojnë në list pagesat e agjencisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 9- Agjencia duhet të ketë një seli në bashkinë Patos dhe aktivitetin e saj duhet ta realizojë brenda ambjentit të miratuar dhe të jenë jo të dukshëm nga jashtë.
- 10- Agjencia duhet të tregtojë edhe artikuj të ndryshëm për procesin e varrimit.
- 11- Të mos ketë detyrime të prapambetura për taksat dhe tarifat vendore, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.
- 12- Agjencia duhet të disponojë pajisje frigoriferike, freskuese dhe hermetizuese për mbajtjen e të ndierit freskët.
- 13- Duhe të ketë në pronësi ose me kontrat qiraje të lidhur para noteriale morgë frigoriferik.
- 14- Duhet të disponojë ambjent në pronësi ose në përdorim me kontratë të lidhur para noterit që do të shërbej për pastrimin e të ndierit.
- 15- Agjencia duhet të disponojë depozit uji me kapacitet jo me të vogël se 500 L.
- 16- Duhet të disponojë mjete të posacme pune për procesin e varrimit dhe veshje të nevojshme për realizimin e shërbimit të zhvarrimit.

KOMISIONI I HARTIMIT TË KRITEREVE

Ina Sauli




Ermenita Mici




Eneo Xhaferi



Nurkë Hazizaj



Gazmira Plesati





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KRYETARI

Nr. 877 Prot.

Patos, më 27/03/2024

URDHËR
Nr. 70, datë 27/03/2024

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E KRITEREVE DHE
KUSHTEVE QË AGJENCITË E SHËRBIMIT FUNERAL DUHET TË
PLOTËSOJNË PËR LICENCIM**

Në mbështetje të nenit 9, pika 1/1, shkronja "b" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004, "Për administrimin e shërbimit të varrimit", të ndryshuar, VKM nr. 711, datë 29.10.2014 "Për miratimin e rregullores ", "Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar me VKM nr. 402, datë 5.7.2023, për te bërë të mundur hartimin e kriterëve dhe kushteve që agjencitë e shërbimit funeral duhet të plotësojnë për licencim,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit, i përbërë si më poshtë:
 - a. Ina Sauli Kryetar
 - b. Ermenita Mici Anëtar
 - c. Nurkë Hazizaj Anëtar
 - d. Gazmira Plesati Anëtar
 - e. Eneo Xhaferri Anëtar
2. Komisioni ka për detyrë të hartoj kriteret dhe kushtet që agjencitë e shërbimit funeral duhet të plotësojnë për licencim, dhe të paraqesi projektvendimin dhe relacion në këshillin bashkiak, brenda datës 15.04.2024.
3. Urdhëri nr. 225, datë 13.12.2023, shfuqizohet.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI
Faton Duro